

**LIGJ**  
**Nr. 31/2017**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË  
GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN “PROGRAM  
PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE II”**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, e 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Program për menaxhimin e mbetjeve II”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2017

**Shpallur me dekretin nr. 10120, datë 7.4.2017, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË  
SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR  
2016  
PËR PROJEKTIN “PROGRAMI PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE II”**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë  
dhe

Qeveria e Republikës Federale e Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partner,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,  
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,  
duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016,  
kanë rënë dakord si vijon:

**Neni 1**

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i mundëson Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose ndonjë marrësi tjetër, i cili do të zgjidhet bashkërisht nga të dyja Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumën e financimit në vlerë të përgjithshme deri në 7 534 862,46 euro (me fjalë: shtatë milionë e pesëqindetridhjetë e katër mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy euro, dyzetegjashtë centë), për projektin “Programi për menaxhimin e mbetjeve II” kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur;

2. Projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse për këtë bien dakord Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi

për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

## Neni 2

1. Përdorimi i shumës të përmendur në nenin 1, paragraf 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlehtësohet, kur kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen brenda vitit aktual. Afati për shumën e përmendur mbaron më 31 dhjetor 2016.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantoj ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e detyrimeve që mund të lindin në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

## Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat e tjera publike, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2, paragrafi 1.

## Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huas dhe e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

## Neni 5

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë më \_\_\_\_\_, në dy origjinalë, secili në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të  
së Shqipërisë  
Për Qeverinë e Republikës  
të Gjermanisë

Republikës

Federale

